



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"

Bordi i Administrimit

Nr. 1428 Prot

Shkodër, më 08.04 2025

VENDIM

Nr. 120, datë 08.04 2025

Për përcaktimin e kodit përkatës dhe gjuhës në të cilën do të zhvillohet programi i studimit i ciklit të dytë, "Master i Shkencave" në "Infermieri Klinike", në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, Departamenti i Lëndëve Klinike, USH, për vitin akademik 2025- 2026, aplikuar për hapje pranë MAS"

Bazuar në ligjin Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 3, pika 2, gërma b; neni 35, pika 1; neni 38. pika 1, gërma "dh"; neni 80; Vendimi nr. 310, datë 11. 05. 2022 "Për specifikimet dhe përmbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", pika 8; Udhëzimin e MAS nr. 2, datë 21. 01. 2025 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin nr. 1, datë 14. 01. 2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programve të studimit si dhe për ndarjen ose bashkimin e insitucionit të arsimit të lartë", i ndryshuar, pika 3 e Kreut IV/A, gërma a); në Statutin e Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi" neni 17, pika 6, gërma f); Vendimi i Senatit Akademik të USH-së nr. 261, datë 21. 11. 2024 "Për miratimin e disa programeve të studimit për vitin akademik 2025-2026"; Shkresën e Fakultetit të Shkencave të Natyrës, nr. 343 prot., datë 07.04.2025, protokolluar në rektorat me nr. 1403, datë 07.04.2025, "Skeda kodifikuese e programit të Studimit Master i Shkencave në "Infermieri Klinike", me vendim te Senatit Akademik, nr.114 të datës 07. 04.2025, Bordi i Administrimit me vendim qarkullues të datës 09.04.2025, me shumicë votash

VENDOSI:

1. Miratimin e kodit dhe gjuhës në të cilën do të zhvillohet programi i studimit, në kuadër të aplikimit për hapjen e programit të studimit të ciklit të dytë, Master i Shkencave në "Infermieri Klinike", në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, Departamenti i Lëndëve Klinike, për vitin akademik 2025- 2026, sipas materialit bashkëngjitur këtij vendimi.



2. Gjuha në të cilën do zhvillohet ky program studimi do të jetë **“Gjuha Shqipe” (S)**; Kodi i programit të Studimit është **72MS0913S**.
3. Ky vendim të ngarkohet në portalin e- Albania, për miratim të mëtejshëm nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetari i Bordit të Administrimit

Prof. Asoc.Dr. Adrian LEKA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"

SKEDË PËR KODIFIKIMIN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT

FAKULTETI I SHKENCAVE TË NATYRËS	
DEPARTAMENTI I LËNDËVE KLINIKE	
Emërtimi i programit të studimit	Master i Shkencave në "Infermieri Klinike"
Niveli i porogramit të studimit sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimit	Niveli 7, Master i Shkencave
Kohëzgjatja e programeve të studimit	2 vite akademike
Lloji programit të studimit	Cikli i dytë Master i Shkencave
Fusha e detajuar ku bën pjesë programi i studimit	0913
Gjuha e programit të studimit	Gjuhë shqipe
Argumentimi lidhur me kodin që duhet të përmbajë programi i studimit	Kodi i këtij programi studimi është përcaktuar sipas vendimit me nr 310, datë 11.05.2022
Kodi i programit të studimit	72MS0913S

